DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU

AC-I.-14-0298

Në ankesat e:

Ankuesit

1. **A0001 M.R** Vushtrri
2. **A0002 M.G,** Vushtrri

Kundër:

Të paditurës

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga "Ilir Konushevci", Nr. 8, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supremë të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili, Gertraud Marx-Leitenberger, Vladimir Kanev dhe Ilmi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur në ankesën e ankuesve kundër aktgjykimit C-II.-13-0340 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të datës 16 shtator 2014, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 tetor 2016, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. **Ankesat e ankuesve refuzohen si të pabazuara.**
2. **Vërtetohet aktgjykimi C-II-13-0340 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, i datës 16 shtator 2014.**

<u>Rrethanat procedurale dhe faktike:</u>

Ndërmarrja Shoqërore 'M-E" Prishtinë, ishte privatizuar më 18 prill 2011.

AKP-ja ka shpallur listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime të NSH-së (lista përfundimtare e NSH-së), në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut, dhe se afati i fundit për parashtrimin e ankesave në DHPGJS, ka qenë 20 prill 2013.

Tri ankesa janë parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime për të fituar 20% e të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, të publikuar nga AKP-ja.

Më 16 shtator 2014, Kolegji i Specializuar IV i DHPGJS-së, nxori aktgjykim për të hedhur poshtë si të papranueshme ankesat e të tre ankuesve.

Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar iu dorëzua ankuesit M.R më 20 shtator 2014 dhe M.G më 23 shtator 2014 dhe 9 tetor 2014.

Kundër këtij aktgjykimi janë parashtruar ankesa nga ankuesit M.R (ankesa **A0001**) dhe M.G (ankesa **A0002**).

Përmes urdhrit të datës 21 korrik 2015, ankesat e parashtruara nga Ankuesit, iu janë dorëzuar AKP-së. AKP-ja nuk iu është përgjigjur këtyre ankesave.

Parashtresat e palëve:

A-0001 *Ankesa nga* M.R ***C-0002***

Më 8 tetor 2014 ankuesi M.R, parashtroi ankesë kundër aktgjykimit përmes së cilit ankesa e tij kundër listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja, ishte hedhur poshtë si e papranueshme. Ai kërkoi nga Kolegji i Apelit që të aprovojë ankesën e tij dhe ta përfshijë atë në listën përfundimtare të NSH-së.

Në ankesë ai konfirmoi se ka parashtruar ankesën e tij pas afatit të paraparë kohor. Ai e arsyetoi këtë se gjatë asaj kohe ka qenë i sëmurë dhe iu është nënshtruar tre intervenimeve kirurgjike/ operacioneve. Ai gjithashtu theksoi se libreza e tij e punës është mbyllur më 2 nëntor 1999 si pasojë e largimit me forcë nga menaxhmenti serb.

Ai i dorëzoi Kolegjit të Apelit kopjet e: raportit mjekësor të Qendrës Emergjente në Prishtinë të datës 22 tetor 2008; udhëzimet për ekzaminime histopatologjike dhe citologjike të datës 12 janar 2008 dhe 6, 8 shkurt 2008; raportit mjekësor të datës 12 janar 2008 dhe 20 janar 2009; fletlëshimet mjekësore nga QKUK-ja në Prishtinë më 14 shkurt 2008 dhe 24 prill 2008; fletlëshimi mjekësor nga klinika Euromed i datës tetor 2010; analizat mjekësore të datës 31 dhjetor 2008, 14 korrik 2009, 16 mars 2009; ankesa e dorëzuar tek Komisioni i Likuidimit të NSH-së 'M-E" (në likuidim) (AL) i datës 9 janar 2014 dhe vendimi i AL-së i datës 26 mars 2013.

A-0002 *M.G* ***C-0001***

Më 21 tetor 2014 ankuesi *M.G* parashtroi ankesë kundër aktgjykimit përmes së cilit ankesa e tij kundër listës përfundimtare të shpallur nga AKP-ja, ishte hedhur poshtë si e papranueshme. Ai kërkoi nga Kolegji i Apelit që të aprovojë ankesën e tij dhe ta përfshijë atë në listën përfundimtare të NSH-së.

Ankuesi pohoi se ka të drejtë që të përfshihet në listë ngase ka punuar në NSH për më tepër se 16 vite. Gjatë viteve të 90ta, ai është dëbuar nga puna në mënyrë diskriminuese nga menaxhmenti serb. Pas luftës është paraqitur në punë por nuk i është dhënë vendi i tij i punës pasi që nuk kishin nevojë për të. Ai e pranon se është vonuar me ankesë por arsyet për këtë janë se ka probleme shëndetësore dhe se vuan nga gurët në veshkë.

Ai pretendon se është viktimë e diskriminimit sepse nuk është përfshirë në listë edhe pse i përmbushë kushtet e parapara me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13.

Ai dorëzoi tek Kolegji i Apelit, kopjet e: vërtetimit nr. 187 të datës 25 dhjetor 2002 të lëshuar nga Drejtorin e NSH-së M.Zh, vërtetimit 08 nr. 87/13 të datës 3 shtator 2013 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, fletlëshimi i datës 20 shkurt 2013, raporti mjekësor i datës 21 shtator 2012 dhe 15 shtator 2012, certifikatën e tij të lindjes.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat janë të pranueshme por të pabazuara.

Kolegji i Apelit vendosi të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme (Shtojca).

Ankesa A 0001

Kolegji i Apelit gjen se Kolegji i Specializuar ka konstatuar saktë se ankesa e M.R është e papranueshme, pasi që është parashtruar pas afatit të paraparë kohor.

Ankuesi nuk është përfshirë në listën përfundimtare të shpallur nga Agjencia, prandaj e ka parashtruar ankesën e tij. Data e fundit për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ka qenë 20 prill 2013. Ankesa e tij është hedhur poshtë si e papranueshme pasi që është parashtruar më 18 nëntor 2013, pas skadimit të afatit të paraparë, përafërsisht 7 muaj.

Në ankesën e tij ankuesi ka shpjeguar se ka probleme shëndetësore të cilat në një farë mënyre e kanë penguar atë që të parashtrojë ankesë me kohë. Si dëshmi ai dorëzoi disa raporte mjekësore dhe fletlëshimin nga spitali, të cilat mbulojnë periudhën kohore prej vitit 2008 gjer në tetor 2010.

Në bazë të nenit 129 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LKP), palët në procedurë të cilat pohojnë se me arsye janë vonuar me parashtresat e tyre, e kanë mundësinë që të parashtrojnë kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme *(status quo ante)*. Një kërkesë e tillë mund të merret në konsideratë vetëm nëse parashtrohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e mosveprimit (sipas nenit 130.3 të LPK-së).

Në rastin në fjalë, ankuesi është vonuar me ankesën e tij kundër listës përfundimtare të NSH-së, të shpallur nga AKP-ja. Kolegji i Apelit gjen se ankuesi nuk mund të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme *(status quo ante)* në fazën e procedurës ankimore sepse e ka humbur afatin për të parashtruar ankesë në gjykatën e shkallës së parë. Afati i paraparë kohor për të parashtruar një kërkesë të tillë ka skaduar më 19 qershor 2013, që është shumë kohë para parashtrimit të ankesës. Për më tepër, dokumentet e dorëzuara në mbështetje të arsyetimit të cekur më sipër nuk e mbulojnë periudhën kur lista është publikuar nga AKP-ja dhe kur ai është dashur që të ndërmerr ndonjë veprim për ta kundërshtuar atë.

Vlerësimet e sipërpërmendura shpijnë tek konkluzioni se Kolegji i Specializuar me të drejtë e ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit; prandaj Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të pabazuar.

Ankesa A-0002

Kolegji i Apelit gjen se Kolegji i Specializuar ka konstatuar saktë se ankesa e M.G është e papranueshme, pasi që është parashtruar pas afatit të paraparë kohor.

Ankuesi nuk është përfshirë në listën përfundimtare të shpallur nga Agjencia, prandaj e ka parashtruar ankesën e tij më 4 shtator 2013. Data e fundit për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posaçme ka qenë 20 prill 2013. Ankesa e tij është hedhur poshtë si e papranueshme pasi që është parashtruar pas skadimit të afatit të paraparë, përafërsisht 4 muaj e 15 ditë.

Ankuesi përmes ankesës si në shkallë të parë ashtu edhe në të dytën ka theksuar se ka probleme shëndetësore të cilat e kanë penguar atë që të parashtrojë ankesë me kohë.

Palët në procedurë të cilat pohojnë se me arsye janë vonuar me parashtresat e tyre, e kanë mundësinë që të parashtrojnë kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme *(status quo ante)*, në bazë të nenit 129 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LKP). Megjithatë, një kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme *(status quo ante)*, në mund të merret në konsideratë vetëm nëse parashtrohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e mosveprimit (sipas nenit 130.3 të LPK-së). Ligji e parasheh që një kërkesë e tillë mund të dorëzohet bashkë me parashtresën të cilën pala është dashur ta dorëzojë, për të cilën gjë e ka humbur afatin. Pasi që ankuesi siç është cekur më sipër në ankesën e tij ka tentuar që të arsyetojë veprimet e tij të vonuara, Kolegji i Specializuar e ka marrë në konsideratë kërkesën e tij dhe dokumentet e paraqitura, por ka konstatuar se gjendja e paraqitur nuk është e mjaftueshme për të arsyetuar parashtrimin e vonuar.

Kolegji i Apelit gjen se afati për parashtrimin e një kërkese të tillë për kthim në gjendje të mëparshme *(status quo ante)*, ka skaduar më 19 qershor 2013, që është shumë kohë para dorëzimit të ankesës; prandaj kërkesa e parashtruar bashkë me ankesën e tij domosdo është hedhur poshtë si e papranueshme. Për më tepër, Kolegji i Apelit pajtohet se të gjeturat e Kolegjit të Specializuar se dokumentet e paraqitura nga ankuesi nuk mbështesin pretendimet e tij se gjendja e tij shëndetësore e ka penguar atë në çfarëdo mënyre për të vepruar me kohë. Fletlëshimi nga QKUK-ja në Prishtinë, i paraqitur nga ankuesi daton nga 20 shkurti 2013, që nënkupton se ai nuk është hospitalizuar në kohën kur është publikuar lista dhe kur është dashur të parashtrohej ankesa.

Taksat gjyqësore / shpenzimet:

Nuk caktohen taksa gjyqësore për lëndët me lista të punëtorëve.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 6 tetor 2016.

Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues